



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 36
Prishtinë, më 20.09.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Albulena Balaj – Halimaj, Driton Çaushi, Abdyl Salihu dhe Mufera Shinik.

Mungoi: Fidan Rekalju, Verica Çeraniq, Nezir Çoçaj dhe Arbërie Nagavci.

Përfaqësues të tjerë: Kujtim Gashi, ministër i MKRS-së, KDI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.9.2018;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa Kreative për Mbështetjen e Sektorëve Kulturorë dhe Kreativë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.9.2018;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10.9.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa Kreative për Mbështetjen e Sektorëve Kulturorë dhe Kreativë ;

Ismajl Kurteshi, tha se arsyeja e thirrjes së kësaj mbledhje, ndërlidhet me seancën plenare që mbahet sot, në të cilën janë paraparë të ratifikohen disa marrëveshje ndërkombëtare, andaj ne si Komision po e shqyrtojmë Projektligjin nr.06/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa Kreative për Mbështetjen e Sektorëve Kulturorë dhe Kreativë dhe po i rekomandojmë Kuvendit për miratim.

Kujtim Gashi, tha se Marrëveshja për Pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa Kreative është nënshkruar me 5 qershor 2018, me Komisionarin Evropian për Arsim, Shkencë, Kulturë dhe Rini, Tibor Navracsics, dhe se e njëjta është biseduar për aprovim me Qeverinë e Kosovës dhe është aprovuar në mbledhjen e datës 31 korrik 2018. Ai tha se pjesëmarrja e Kosovës në kuadër të këtij programi është e rëndësishë së veçantë, pasi mbështetja për sektorët kulturorë dhe audiovizuel është në përputhje edhe me politikat programore të Qeverisë së Kosovës dhe veçanërisht me politikat programore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Gashi tha se ky program kontribuon edhe në ruajtjen e diversitetit kulturorë dhe gjuhësorë, në nxitjen e rritjes së ekonomisë së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, përshtatjen e sektorëve kulturorë dhe kreativë me epokën digjitale si dhe në krijimin e mundësive të reja ndërkombëtare, tregjeve dhe audiencës. Kostoja vjetore financiare që Kosova do t'i paguajë buxhetit të përgjithshëm të BE-së për të marrë pjesë në nënprogramin e kulturës dhe në fushat ndërsektoriale do të jetë 35.000 euro, e cila është parapara në buxhetin e saj nga MKRS-ja dhe që e njëjta do t'i procedohet BE-së sipas marrëveshjes.

Ministri Gashi, kërkoi nga deputetët që kjo marrëveshje t'i propozohet Kuvendit të Kosovës për miratim.

Teuta Haxhiu, tha se kjo marrëveshje i motivon deputetët që marrëveshjet të cilat arrihen në mes të Republikës së Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, apo cilitdo shtet, të planifikohen drejtë dhe që obligimet të planifikohen në buxhetin e Kosovës, në mënyrë që të tregohet serioziteti i shtetit karshi obligimeve ndaj partnerëve ndërkombëtarë. Ratifikimi i këtyre marrëveshjeve të rëndësishme, ajo i cilësoi si kontribut direkt i deputetëve në jetën e qytetarëve të Kosovës.

Valentina Bunjaku, tha se të gjitha këto marrëveshje janë në interes të Republikës së Kosovës, ndërsa pyeti Ministrin se cili është roli i UNMIK-ut në këtë marrëveshje dhe çfarë funksioni luan në këtë projektligj.

Kujtim Gashi, tha se kjo marrëveshje është nënshkruar në mes të Kosovës dhe BE-së dhe që Kosova është trajtuar si shtet në këtë proces dhe se nuk ka involvim të UNMIK-ut.

Valentina Bunjaku, tha se tek projektligji parashihet edhe roli i UNMIK-ut.

Kujtim Gashi, tha se kjo marrëveshje është trajtuar me shumë vëmendje ku të përfshirë kanë qenë të gjithë aktorët dhe ekspertët në këtë proces dhe që për herë të parë po dëgjon që UNMIK-u ka lidhje me këtë proces.

Ismajl Kurteshi, tha se shpreson që Qeveria e Kosovës nuk nënshkruan marrëveshje në të cilat Kosova nuk trajtohet si shtet. Ai tha se është në interes të të gjithëve që ky projektligj të përcillet në seancën e Kuvendit dhe t'i rekomandohet ratifikimi i kësaj marrëveshjeje. Ai kërkoi nga anëtarët e Komisionit që me votë të deklarohen në lidhje me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Komisioni, me shumicë votash, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet Projektligjin nr.06/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrjen e Kosovës në programin Evropa Kreative për Mbështetjen e Sektorëve Kulturorë dhe Kreativë.

4. Të ndryshme.

Në këtë pikët të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

**Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi**